



Сектор за индустриска и
инвестициска политика и
општествена одговорност

Departamenti për politika industriale
dhe investuese dhe përgjegjësi sociale

Në bazë të Programit për mbështetjen e konkurrueshmërisë së industrisë përpunuese dhe përgjegjesisë sociale për vitin 2025, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 29/2025), Masa 2: Kompensimi i një pjese të shpenzimeve të subjekteve afariste për akreditimin e laboratorëve, zgjerimin e fushës së akreditimit të laboratorëve ekzistues për testim ose prokurim të pajisjeve për laboratorë për lëshimin në treg të produkteve cilësore dhe të sigurta, Ministria e Ekonomisë dhe punës publikon:

THIRRJE PUBLIKE

për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për laboratorë

I

Lëndë e Thirrjes Publike është kompensimi i një pjese të shpenzimeve për akreditimin e laboratorëve, zgjerimin e fushës së akreditimit të laboratorëve ekzistues për testim ose prokurimin e pajisjeve për laboratorët për lëshimin në treg të produkteve cilësore të sigurta në shumë totale prej 3,000,000.00 denarësh, për aktivitetet e mëposhtme:

1. Akreditimi i laboratorëve:

- 1.1. Prokurimi i standardeve/specifikimeve teknike për metodat laboratorike
- 1.2. Trajnim për zbatimin e metodave nga fusha e akreditimit
- 1.3. Auditimi i akreditimit me Institutin e Akreditimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose auditimi mbikëqyrës me Institutin e Akreditimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

2. Zgjerimi i fushës së akreditimit të laboratorëve ekzistues

- 2.1. Prokurimi i standardeve/specifikimeve teknike për metodat laboratorike
- 2.2. Trajnim për implementimin e metodave nga fusha e akreditimit
- 2.3. Auditimi i akreditimit me Institutin e Akreditimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose auditimi mbikëqyrës me Institutin e Akreditimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut



Сектор за индустриска и
инвестициска политика и
општествена одговорност

Departamenti për politika industriale
dhe investuese dhe përgjegjësi sociale

3. Prokurimi i pajisjeve për laboratorë për lëshimin në treg të produkteve cilësore dhe të sigurta

3.1. Prokurimi i pajisjeve ose pajisimi plotësues i laboratorëve dhe trajnimi për përdorimin e pajisjeve

3.2. Kalibrimi i pajisjeve

II

Ministria e Ekonomisë dhe punës kompenson një pjesë të shpenzimeve në vlerë prej 50% të shpenzimeve të vërtetuara të subjekteve afariste, por jo më shumë se 500.000,00 denarë individualisht për secilin subjekt afarist aplikues për mjete, në përputhje me mjetet në dispozicion.

III

E drejta për pjesëmarrje në thirrjen publike

Të drejtë për pjesëmarrje në thirrjen publike kanë subjektet afariste me veprimtarinë dominuese/kodin kryesor të të ardhurave

- Testimi teknik dhe analizat, në përputhje me Klasifikimin Nacional të Veprimtarive - NKD. Rev. 2 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 147/2008, 4/2013 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 35/2024), dhe njësitë organizative pranë fakulteteve, të cilat merren me këtë veprimtari.

Një aplikues mund të merr mjete financiare vetëm për një aktivitet.

Shfrytëzues i subvencionit nuk mund të jetë subjekti afarist që ka marrë ndihmë shtetërore me Thirrjen Publike për rimbursimin të investimeve në laboratorin për vitin 2024.



Сектор за индустриска и
инвестициска политика и
општествена одговорност

Departamenti për politika industriale
dhe investuese dhe përgjegjësi sociale

Kërkesa për aplikim, formulari për deklaratën e ndihmës së ndarë shtetërore, deklarata "Formulari i Deklaratës 2025" dhe udhëzimet për përgatitjen e raportit për projektin e realizuar me indikatorë të suksesit, janë të qasshme në ueb-faqen e Ministrisë së Ekonomisë dhe punës www.economy.gov.mk (formularët 1, 2, 3 dhe Udhëzimi).

IV

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Formulari 1 - PIPOO 2025 Masa 2 “Kërkesë për mbështetje për rritjen e konkurrueshmërisë për industrinë përpunuese - Kompensimi i një pjese të shpenzimeve për laboratorët për testimin e produkteve;
- Formulari 2 - Deklaratë e ndihmës së ndarë shtetërore, të noterizuar;
- Formulari 3 - Deklaratë e noterizuar;
- Gjendja aktuale e subjektit afarist të lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, jo më i vjetër se 2 (dy) muaj;
- Informacion për gjendjen ekonomike dhe financiare të subjektit afarist të lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, jo më i vjetër se 2 muaj, nga i cili shihet se subjekti afarist ka interpretim pozitiv në pjesën e indikatorëve për vlerësimin e shoqërisë;
- Dokument që konfirmon aktivitetin e njësive organizative (laboratorëve) në fakultete (Statut, Gjendja aktuale e lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- Certifikatë për tatimet dhe kontributet e paguara nga Drejtoria e të Ardhurave Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, jo më të vjetër se 2 (dy) muaj;
- Marrëveshja ndërmjet subjektit afarist dhe përpiluesit, lidhur gjatë viteve 2024 dhe 2025;
- Faturë nga përpiluesi, lëshuar në qarkullim gjatë viteve 2024 dhe 2025;
- Deklaratë nga banka e depozituesit që tregon se subjekti afarist ka shlyer plotësisht detyrimin ndaj përpiluesit, në përputhje me Marrëveshjen;
- Raport për projektin e realizuar me indikatorët e suksesit (përgatitur në përputhje me udhëzimin);



Сектор за индустриска и
инвестициска политика и
општествена одговорност

Departamenti për politika industriale
dhe investuese dhe përgjegjësi sociale

- Fletëpagesat për tarifat administrative në shumë prej 50,00 denarë dhe 250,00 denarë.

V

Thirrja publike dhe parashtrimi i dokumenteve:

Thirrja publike është publikuar në ueb faqen e Ministrisë së Ekonomisë dhe punës www.economy.gov.mk.

Aplikimi duhet të dorëzohet plotësisht, me të gjitha dokumentet e nevojshme.

Kërkesa për aplikim (Formulari 1) dhe Raporti për projektin e realizuar duhet të nënshkruhen nga personi kompetent i subjektit afarist dhe të vërtetohen me vulë.

Deklarata për ndihmën e ndarë shtetërore (Formulari 2) dhe Deklarata (Formulari 3) duhet të nënshkruhen nga personi kompetent i subjektit afarist, të vulosura dhe të noterizuara.

Pjesa tjetër e dokumentacionit dorëzohet në origjinal ose në kopje. Nëse dokumentacioni dorëzohet në kopje, vërtetësia e secilës faqe vërtetohet nga personi kompetent i subjektit afarist me nënshkrim personal me dorë dhe vërtetohet me vulë. Dokumentacioni në gjuhë të huaj dorëzohet në kopje dhe përkthim të vulosur nga përkthyes i autorizuar gjyqësor.

Në rast se kërkesa e parashtruar për subvencionim është e pakompletuar, pra mungon një nga dokumentet e kërkuara, Komisioni do t'i kërkojë me shkrim aplikuesit të plotësojë kërkesën me dokumentet që mungojnë brenda një afati të caktuar. Për të respektuar parimin "i pari i ardhur, i pari i shërbyer", për Kërkesat me dokumentacion jo të plotë, data e paraqitjes së kërkesës do të konsiderohet data e plotësimit të fundit në kërkesë, gjegjësisht data kur Kërkesa për subvencionim do të jetë plotësisht e kompletuar. Ministria e Ekonomisë dhe punës rezervon të drejtën të kërkojë dorëzimin e projektit të



Сектор за индустриска и
инвестициска политика и
општествена одговорност

Departamenti për politika industriale
dhe investuese dhe përgjegjësi sociale

plotë të përgatitur, të monitorojë projektin, të vizitojë kompaninë tuaj dhe të verifikojë vetë gjetjet nga raporti

VI

Shpërndarja e mjeteve

Kërkesat e parashtruara shqyrtohen nga një Komision i formuar nga Ministri i Ekonomisë dhe punës . Kërkesat e miratuara do t'u paguhen aplikuesve në varësi të mjeteve të disponueshme nga Buxheti për vitin 2025, të parashikuara për këtë qëllim, sipas radhës së regjistrimit të tyre në arkivin e Ministrisë së Ekonomisë (i pari i ardhur i pari shërbehet), deri në shterimin e mjeteve.

Nëse mjetet shteren derisa ende është në vazhdim thirrja publike, Ministria e Ekonomisë dhe punës do të publikojë Njoftim për shterimin e mjeteve në dispozicion në ueb faqen e saj www.economy.gov.mk.

VII

Mënyra dhe afati për dorëzimin e kërkesave

Kërkesa me dokumentacion të plotë mund të shkarkohet nga uebfaqja e Ministrisë së Ekonomisë dhe punës www.economy.gov.mk.

Kërkesa së bashku me dokumentacionin e nevojshëm duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur në Arkivin e Ministrisë së Ekonomisë dhe punës, rr. "Jurij Gagarin" nr. 15, Shkup ose dërgohet me postë rekomanduese.

Nëse kërkesa dorëzohet përmes postës, data e parashtrimit të të njëjtës do të llogaritet data kur kërkesa ka arritur dhe është regjistruar në Arkivin e Ministrisë së Ekonomisë dhe punës .

Në pjesën e përparme të zarfit duhet të qëndrojë:

Drejtuar Ministrinë e Ekonomisë dhe punës

Në pjesën e pasme të zarfit duhet të thotë:



Сектор за индустриска и
инвестициска политика и
општествена одговорност

Departamenti për politika industriale
dhe investuese dhe përgjegjësi sociale

Emri dhe selia e ndërmarrjes.

Për THIRRJE PUBLIKE për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për
laboratorë me shënimin “MOS HAP”.

Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është 31.07.2025

email: industry@economy.gov.mk tel: (02) 3093 465; (02) 3093 466;
www.economy.gov.mk